



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRIA  
SEKRETARIATI TEKNIK I KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT

6 Qershor 2018

“Takimit të Dytë Kombëtar mbi Ecurinë dhe Vazhdimësinë e Projektit BRIGAIID”

Të nderuar pjesëmarrës,

Së pari me lejon që në emër të Agjencisë për Menaxhimin e Burimeve Ujore, të shpreh vlerësimin për projektin BRIGAIID i cili ka në fokus kërkimin, inovacionet dhe zgjidhjet alternative për kapërcimin e problematikave të katastrofave natyrore si Përmytjet, Thatësitat dhe Moti Ekstrem. Të gjithë jemi të ndërgjegjshëm për vunerabilitetin e vendit tonë ndaj këtyre ngjarjeve, të cilat sjellin pasoja tepër të larta sociale dhe ekonomike.

Do të doja të sillja në vëmendjen tuaj dy dokumente strategjike të sektorit të ujit si Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore (i cili është miratuar së fundmi) dhe Programin Kombëtar i Sektorit të Ujit (i cili është në process miratimi). Këto dokumente shërbejnë si një bazë e fortë për planifikimin dhe zhvillimin mëtej të sektorit duke parashikuar rëndësinë inovacioneve, si zgjidhje për problematikën e hasura. Mendoj që ky projekt vjen në momentin e duhur të implementimit në realitet të këtyre dy dokumentave, dhe inovacionet e këtij projekti mund të integrohen si zgjidhje në tërësinë e masave që do të ndërmerren në këtë kuadër. Mendoj së të gjithë aktorët e sektorit, janë të interesuar të ofrojnë jo vetëm zgjidhje individuale por zgjidhje ndërinstitucionale, që mund të integrohen lehtë në planet tona reciproke të punës duke maksimizuar kështu punën dhe energjinë tonë.

Sikundër mund të jeni në dijeni, Agjencia për Menaxhimin e Burimeve Ujore është pasuese e ish-Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, por tashmë e pajisur me kompetenca të plota në menaxhimin e integruar të burimeve ujore. Këto

ndryshime ligjore dhe institucionale, do të na mundësojnë shmangien e problematikave të së shkuarës ku kishte disa institucione me rol aktiv në sektor dhe natyrisht presim që të rrisim shkallën e bashkëpunimit dhe përfshirjen në iniciativa si kjo e sotmja.

Së fundmi, dëshiroj sinqerisht të falënderoj Ambasadën e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta, për mbështetjen e vazhdueshme në përmirësimin e sektorit të ujit në vend. I uroj Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit suksese në zbatimin e projektit. AMBU mbetet e angazhuar në menaxhimin e integruar të burimeve ujore dhe mbështet çdo zgjidhje inovatore, si këto që paraqet ky projekt.

Ju faleminderit dhe suksese në vijim